



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 128/13
Prishtinë, më 04.10.2013, ora 12:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Albana Fetoshi, Xhevdet Neziri dhe Sevdije Lama.

Mungoi : Naser Osmani dhe Duda Balje.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli, Imba Rudaku dhe Arbëreshë Kosumi.

Gjithashtu ishin të pranishëm: Hamdi Berbatovci nga Ministria e Diasporës, Rejhane Zylfijaj dhe Njomza Ilazi nga GIZ.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 27.09.2013;
3. Shqyrtimi i kërkesës së Ministrisë së Diasporës lidhur me aprovimin e paradhënies për realizimin e aktiviteteve të Ministrisë në kuadër të projektit “Ditët e kulturës së Kosovës në diasporë”;
4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente të Grupit Punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.03/L-222 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-102;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e mbajtura të komisionit, dt. 27.09.2013

Kryetarja konstatoi se procesverbali miratohet pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i kërkesës së Ministrisë së Diasporës lidhur me aprovimin e paradhënies për realizimin e aktiviteteve të Ministrisë në kuadër të projektit “Ditët e kulturës së Kosovës në diasporë”

Kryetarja sqaroi se kërkesa e Ministrisë së Diasporës është të lejohet pagesa e paradhënjes për realizimin e katër aktiviteteve të ministrisë në kuadër të projektit të kulturës së Kosovës në Diasporë. Arsyetimi i kërkesës së Ministrisë së Diasporës është bazuar në nenin 11.2 të ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013 sipas të cilit Qeveria mund ta aprovojë pagesën e paradhënjes prej më shumë se 30% e deri në 100% të vlerës së kontratës për mallra dhe shërbime vetëm pas rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa. Në përmbajtjen e kërkesës shohim se ministria ka planifikuar të realizojë katër aktivitete në kuadër të projektit ditët e kulturës së Kosovës në diasporë janë të prezantuar shumat e veçanta për tri aktivitete kurse për një aktivitet nuk është prezantuar vlere. Në kërkesë nuk i kemi të dhënat të qarta që sqarojnë se sa përqind e vlerës së kontratës për financimin e mallrave dhe shërbimeve për realizimin e aktiviteteve të ministrisë kërkohet të paguhet me paradhënie, nuk është sqaruar sa duhet çështja e pagesës së paradhënjes për projektet sa i përfshijnë shumat totale 30 % të kontratës apo një përqindje më të madhe siq e lejon ligji deri në 100% pagesën e paradhënjes. Poashtu materiali i dërguar në komision për shqyrtim nuk kemi ndonjë shkresë nga Ministria e Financave apo ndonjë sqarim me shkrim që tregon se ministrit përkatëse janë konsultuar lidhur me këtë kërkesë para se ajo të procedohet në Komisionin për Buxhet dhe Financa.

Hamdi Berbatovci sqaroi se aktivitetet në fjalë është ditët e kulturës së diasporës, ky aktivitet është në bazë të planit veprimit të Ministrisë së Diasporës në bazë të buxhetit që ka ministria e ka të aprovuar këtë buxhet që do të thotë nuk nevojiten mjete shtesë është i aprovuar edhe nga ana buxhetore kjo ka të bëjë vetëm me mënyrën e pagesës. Ky projekt është për çdo vit dhe në raportin e auditimit e kemi marrë një vërejtje sepse pagesa e projektit ka qenë në formën e avansit, pra është dashtë të paguhet para se të kryhet aktiviteti. Ajo çka ne kemi kërkuar nga komisioni dhe rekomandimi i auditorit të përgjithshëm ka qenë është që pagesat të cilat bëhen paraprakisht të merret një rekomandim nga Komisioni për Buxhet dhe Financa .

Latif Gashi është një mungesë e përfaqësuesve të Ministrisë së Financave të diskutojmë me ta, mirëpo nga materiali që e kemi dhe nga sqarimet që i dha mua më intereson të di ju si Ministri e diasporës apo organet e juaja të prokurimit a keni pas vërejtje nga auditori për mënyrën e kontraktimit të shërbimit. E Kuptuam se auditori ka kërkuar që ne si komision ta japim mendimin tonë dhe unë jam pro aprovimit të kësaj kërkesë duke marrë parasysh që është një shumë e vogël në raport me të mirat që diaspora dhe mërgata ia sjellin vendit tonë.

Hykmete Bajrami sa përqind e këtyre aktiviteteve është paradhënia dhe a janë të parapara në buxhetin e vitit 2013 ?

Hamdi Berbatovci paradhënia është 100 % dhe janë të parapara në buxhet.

Sali Asllanaj un kisha pas dëshirë me pa që këta e kanë kontraktuar një punë dhe tash të japin paradhënien këtu nuk po shkruan kush është kontraktori dhe kush është implementuese i këtyre projekteve. Do të duhet të gjeni formën e tenderimit që një kompani i merr këto mjete pastaj i kompenson punët dhe shpërblimet e të gjitha këto, përndryshe ne nuk mundë të ju japim leje dhe ti shkelim procedurat e prokurimit.

Hamdi Berbatovci natyra e fushë veprimtarisë së ministrisë tonë është pakë me specifike se tek ministrinë e tjera.

Xhevdet Neziri është hera e parë që po na vjen një kërkesë e tillë nga një agjencioni buxhetor në këtë formë, këta e paskan të paraparë në buxhet. Nëse do të kishin mungesë të parave është diqka tjetër po këta parat i paskan këta u dashtë me i planifikua dhe të merren vesh me Ministrinë e Financave dhe me zgjedhë këtë problemë.

Kryetarja pikën e tretë nuk mundë ta përkahim sepse nuk ka vlerë dhe ne nuk mundë të miratojmë një projekt për tu realizuar kur nuk ka shumë. Ne nuk e kemi vlerën e kontratës dhe ligji obligon që në bazë të vlerës së kontratës, ne mund të rekomandojmë.

Hamdi Berbatovci fillimisht në lidhje pyetjen e deputetit Gashi për procedurat. Raporti i Auditorit e kam edhe me vete nuk na ka dhënë vërejtje për procedurat, procedurat janë zhvilluar dhe prapë zhvillohen konform procedurave të ligjit të prokurimit publik, mirëpo është qështja lidhuer me ekzekutimin e pagesës së paradhënies dhe jo me procedurat. Sipas tyre rreziku është që ndoshta nuk kryhen ai shërbim dhe paratë janë dhënë pastaj mundet me pas ndonjë materialitet .

Kryetarja ju i keni zhvilluar procedurat auditori nuk ju ka dhënë vërejtje mirëpo ne si komision duhet me ditë që i keni kryer procedurat dhe tash keni nevojë për të lejuar pagesën e paradhënies. Ne si komision nuk e kemi dokument të bashkangjitur që tregon se i keni kryer procedurat, nuk e kemi kontratën që e keni nënshkruar siç kërkon ligji.

Latif Gashi sa i përket asaj që ne ta pengojmë Ministrinë apo ta kushtëzojmë që ti ndjek të gjitha procedurat e pastaj të ia aprovojmë, kjo nuk është arsye. Mund të themi se Komisioni i aprovon kërkesat e tjera të cilat kanë mbulueshmëri si dhe rekomandojmë që të ndiqen procedurat e prokurimit.

Kryetarja theksoj se në ligji shkruan se Qeveria mund ta aprovoj pagesën e paradhënies prej më shumë se 30% deri në 100% të vlerës së kontratës për mallra dhe shërbime pas rekomandimit nga Komisioni për Buxhet. Nuk kemi të drejtë me miratu për shkak se kërkesa ka ardh prej Ministrisë dhe jo Qeverisë. Duhet të bëhet e ditur vlera e kontratës.

Sali Asllanaj vlerësoj se duhet ta formulojmë vendimin në atë mënyrë që mbas përfundimit të procedurave të ketë në dispozicion mundësinë e paradhënies 100%.

Hamdi Berbatovci sqaroj se projekti është ditët e kulturës në diasporë, në këtë projekt përfshihen katër pesë aktivitete të cilat zhvillohen në vende të ndryshme. Në fund do të barazohen me fatura tek ne sado që ka shpenzuar.

Kryetarja si komision nuk dua të marrë përgjegjësinë e problemeve të Ministrisë, dua të marrë vendim në bazë të ligjit i cili thotë se duhet të lejohet 30 deri 100% të vlerës së Kontratës dhe jo të vlerës së planifikuar. Çfarëdo vendimi që marrim bëjmë shkelje pasi që nuk e kemi të ditur vlerën e kontratës.

Latif Gashi kërkoj që të merret parasysh vullneti i deputetëve që ta formulojmë rekomandimin në mënyrë politike pa e ngarkuar me përgjegjësi tjetër, pa i dhënë të drejtë Ministrisë që ti shkel procedurat e tjera prokurimit, duke mos e penguar punën e Ministrisë që ta zhvilloj projektin.

Hasime Krasniqi mbështes propozimin e Kryetares sepse me të vërtet në bazë të ligjit ne si komision nuk duhet të bëjmë një vendim për ndarje që nuk bazohet në ligj. Në parim kërkesa është e arsyeshme është dhe të gjithë jemi pro kësaj kërkesë. Le të përfundojnë procedurat të cilat janë sipas ligjit të prokurimit.

Sali Asllanaj mendoj se specifikat e kësaj ministrie janë të tilla që nëse e shtyjme vendimin mund të dështoj projekti.

Albana Fetoshi konsideroj se projekti i tretë është shumë i rëndësishëm që ka të bëjë me sensibilizimin e prindërve për dërgimin e fëmijëve në shkolla shqipe. Por ajo që më intereson është se pse në këtë projekt nuk ka shumë, a ekziston mundësia me lidh kontratë me këtë projekt dhe të realizohet?

Hamdi Berbatovci sqaroj se ky projekt do të realizohet mirëpo nuk janë specifikuar të gjitha detajet e koston financiare. Plani veprimit ende nuk është certifikuar se cilat shpenzime do të bëhen. Vlera e përafërt do të jetë 10.000€ prej Ministrisë së Diasporës sepse shumica e aktiviteteve që i zhvillon Ministria e diasporës janë në bashkëpunim dhe vetëm si motivim me mjete simbolike për të marrë pjesë.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë :

Rekomandim

1. Komisioni për Buxhet dhe Financa, i rekomandon Qeverisë së Republikës së Kosovës, të miratojë Kërkesën nr.896, dt.18.09.2013 e Ministrisë së Diasporës për aprovimin e pagesës e paradhënies në shumë prej tremëdhjetë mijë e nëntëqind euro (13,900.00 €) që është vlera e njëqind përqind (100%) e kontratës për mallra dhe shërbime për financimin e aktivitetit “EKSPLO-DIASPORA 2013”.
3. **Shqyrtimi i Raportit me amendamente të Grupit Punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.03/L-222 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-102**

Komisioni me pesë për (Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Xhevdet Neziraj, Sevdije Lama, Hasime Krasniqi) një votë kundër (Albana Fetoshi) dhe asnjë abstenim, nxori këtë

Rekomandim

Miratohen amendamentet e Grupit Punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.03/L-222 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-102 dhe raporti me amendamente procedohet për shqyrtim në komisionet tjera të përhershme.

Mbledhja përfundoi: 12:36

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj